

Dt. 16/01/2018

**AKTI I THEMELIMIT TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"GREEN REVOLUTION" SH.P.K.**

**NENI 1**

Themelohet shoqeria tregtare me pergjegjesi te kufizuar "GREEN REVOLUTION" sh.p.k. mbeshtetur ne ligjin Nr. 9901, date 14.4.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" te ndryshuar, ligjin Nr. 9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", ligjin Nr. 9121, date 28.7.2003, "Per Mbrojtjen e Konkurrences", Kodin Civil dhe Kodin e Punes, me ortak te vetem themelues si vijon:

**Z. Leonard Mustafallari**, i biri i Nazmi, lindur me 12.01.1976 ne Çorovodë dhe banues ne Durrës, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i identifikuar me Pasaportën nr. BI2994803 dhe Nr. Personal H60112193I.

**SELIA E SHOQERISE**

**NENI 2**

Selia e Shoqerise ndodhet në Skrapar, në adresën fshati Mollas në Zonën Kadastrale 2718, nr Nr. Pasurie 38/34.

Shoqeria ka te drejte te hapi filiale te tjera brenda territorit te Republikes se Shqiperise, ne varesi te selise Qendrore qe ndodhet ne qytetin e Skraparit.

**KOHEZGJATJA E AKTIVITETIT TE SHOQERISE**

**NENI 3**

3.1. Kohezgjatja e shoqerise do te jete me afat te pakufizuar. Ky afat fillon me regjistrimin e shoqerise ne Regjistrin Tregtar.

3.2. Ortaku i Shoqerise mund te vendose kufizimin e afatit te veprimtarise dhe me pas zgjatjen e saj nje apo disa here, sipas nje vendimi te posacem te marre prej tij.

**OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

**NENI 4**

Objekti i veprimtarise se Shoqerise do te jete:

- Mbjellja dhe kultivimi i arrorëve, ullishtave si dhe fruta-perimeve;
- Prodhimi, përpunimi dhe tregtimi i produkteve bujqësore dhe blektorale;
- Zhvillimi i agroturizimit dhe promovimit të zonave turistike;

- Blerja, shitja dhe marrja e dhënia e pasurive të paluajtshme me qira afatshkurtër ose afatgjatë si dhe zhvillimi i tyre;
- Përvec kesaj ne perputhje me legjislacionin shqiptar, shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet qe lidhet me objektin e mesiperm.

## KAPITALI I SHOQERISE

### NENI 5

5.1. Kapitali themeltar i shoqerise eshte 19,284,000 leke.

5.2. Kapitali themeltar i shoqerise perbehet nga nje kuote me vlerë 19,284,000 lekë.

5.3. Ky kapital perbehet nga kontribute ne natyre te ortakut te vetem te shoqerise (sipas akteve te ekspertimit bashkelidhur ketij Akti Themelimi), kontribut ky qe perbehet nga:

- 1. Tokë Arë me sip. 1062 m<sup>2</sup>, me Nr. Pas. 77/6, Zona kadastrale Nr. 2718, Vol. 1, faqe 106 në vlerën prej **424,800 lekë**;
- 2. Tokë Arë me sip. 700 m<sup>2</sup>, me Nr. Pas. 90/21, Zona kadastrale Nr. 2718, Vol. 4, faqe 70 në vlerën prej **280,000 lekë**;
- 3. Tokë Arë me sip. 2100 m<sup>2</sup>, me Nr. Pas. 93/12, Zona kadastrale Nr. 2718, Vol. 1, faqe 111 në vlerën prej **840,000 lekë**;
- 4. Tokë Arë me sip. 687 m<sup>2</sup>, me Nr. Pas. 164/2, Zona kadastrale Nr. 2718, Vol. 1, faqe 112 në vlerën prej **274,800 lekë**;
- 5. Tokë Arë me sip. 2375 m<sup>2</sup>, me Nr. Pas. 199/26, Zona kadastrale Nr. 2718, Vol. 1, faqe 113 në vlerën prej **950,000 lekë**;
- 6. Tokë Arë me sip. 3100 m<sup>2</sup>, me Nr. Pas. 45/3, Zona kadastrale Nr. 2718, Vol. 1, faqe 105 në vlerën prej **1,240,000 lekë**;
- 7. Tokë Arë me sip. 11060 m<sup>2</sup>, me Nr. Pas. 38/34, Zona kadastrale Nr. 2718, Vol.4, faqe 68 në vlerën prej **4,424,000 lekë**;
- 8. Gjë e Gjallë (të leshta), 600 krerë në vlerën prej 9,500 lekë/krerë, në total në vlerën prej **5,700,000 lekë**;
- 9. Gjë e Gjallë (gjedhë), 30 krerë në vlerën 150,000 lekë/krerë, në total në vlerën prej **4,500,000 lekë**;
- 10. Gjë e Gjallë, (njëthundrakë), 5 krerë në vlerën prej 130,000 lekë/krerë, në total **650,000 lekë**.

5.4. Shoqeria mund te shtoje ose zvogeloje kapitalin ne varesi te nevojave dhe rezultateve te saj sipas vendimit te ortakut te vetem.

## **ORGANET DREJTUESE**

### **NENI 6**

Organet drejtuese te shoqerise jane: Ortaku i vetem dhe Administratori.

## **DREJTIMI I SHOQERISE**

### **NENI 7**

7.1. Shoqeria do te drejtohet dhe administrohet sipas menyres se percaktuar ne ligj dhe ne Statutin e Shoqerise nga administratori i saj.

7.2. Ortaku i vetem ushtron te gjitha kompetencat qe i njihen me ligj dhe statut per shkak te kesaj cilesie.

7.3. Aktualisht administrator i Shoqerise do te jete z. Leonard Mustafallari identifikuar me Pasaportën nr. BI2994803 dhe Nr. Personal H60112193I.

## **ZHVILLIMI I SHOQERISE**

### **NENI 8**

Shoqeria mund te ndryshoje emertimin e saj, seline ligjore, objektin, mund te zmadhoje apo te zvogeloje kapitalin themeltar, mund te pranoje ose te largoje ortake.

## **MARREDHENIET E PUNES NE SHOQERI**

### **NENI 9**

Shoqeria do te perpiloje dokumentet perkatese per punesimin e personave te trete duke respektuar dispozitat e Kodit te Punes.

## **VULA E SHOQERISE**

### **NENI 10**

Shoqeria ka vulen e saj ne madhesi te zakonshme me tekstin perreth saj.

## **FITIMI I PERSONALITETIT JURIDIK**

### **NENI 11**

Shoqeria do te rregulloje veprimtarine e saj edhe me Statutin e saj, i cili pasi te nenshkruhet nga ortakut themelues do te fitoje personalitet juridik ne ditën e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

## **BILANCI DHE FITIMI**

### **NENI 12**

12. 1. Viti financiar fillon më datë 1 Janar dhe përfundon më datë 31 Dhjetor të çdo viti.

12.2. Llogaritë vjetore, inventari raportet mbi operacionet e viti financiar dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabël, miratohen nga ortaku i vetëm.

12.3. Miratimi i dokumenteve mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.

## **FUNKSIONIMI I SHOQERISE**

### **NENI 13**

Rregullat për funksionimin dhe drejtimin e shoqërisë përveç këtij Akti Themelues janë të përcaktuara në Statutin e Shoqërisë.

## **ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE**

### **NENI 14**

Te gjitha mosmarreveshjet me organet shtetërore, personat juridike e fizike vendas e të huaj, do të zgjidhen nga Gjykata kompetente sipas legjislacionit në fuqi.

## **DISPOZITA TE TJERA**

### **NENI 15**

Ky akt themelimi përpilohet në katër kopje, duke patur secila kopje fuqi të plotë ligjore.

Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortaku i vetëm themelues i Shoqërisë "GREEN REVOLUTION" sh.p.k..

**Leonard MUSTAFALLARI**

